



Planuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivered	18 - 05 2021	1 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBUEK	2447/2021		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.338/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për shqyrtimin ankesave në përbërje: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1514/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A/02/528/2014 të datës 04.11.2014 të parashtruar nga ankuesi nga Leposaviqi i përfaqësuar nga Avokat me adresë rruga “Dëshmorët e Kombit” pa numër në Ferizaj, kundër organit të punësimit/Komuna e Leposaviqit, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

**I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A/02/528/2014 e datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesi e rishqyrtuar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit me numër A.nr.1514/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

**II. SHFUQIZOHET** Vendimi i datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit.

**III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Leposaviqit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës “Zyrtar i Lartë Financiar” sipas Akt Emërimit me Nr. 166A/13 të datës 02.09.2013 në Komunën e Leposaviqit më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës dhe duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës (largimit nga lista e pagave) deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 166A/13 të datës 02.09.2013 në Komunën e Leposaviqit në pozitën “Zyrtar i Lartë Financiar”, në bazë të Vendimit të datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit është larguar nga lista e pagave e Komunës së Leposaviqit. Ankuesi i pakënaqur me heqjen nga lista e pagave më datë 10.09.2019 i është drejtuar më kërkesë tek Kryetari i Komunës së Leposaviqit, ndërsa më datë 01.01.2014 i është drejtuar me ankesë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit, nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesit më datë 04.11.2014 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3296/2014 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.11.2014 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Leposaviqit. Komuna e Leposaviqit më datë 01.12.2014 nëpërmjet përgjigjes dy faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.12.2014 ka kërkuar informata zyrtare nga Ministria e Administratës Publike lidhur me rastin e ankuesit, ndërsa Ministria e Administratës Publike më datë 31.12.2014 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me heqjen nga lista e pagave duke dërguar edhe formularët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.02.2015 ka nxjerr Vendim me numër A/02/528/2014 me të cilin ka shpall veten jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit. Ankuesi kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 06.02.2019 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.430/15b me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke anuluar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e kthyer çështjen e rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 15.05.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin përmes përfaqësuesit të tij për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1514/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.05.2020.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke e rishqyrtuar ankesën e ankuesit, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3296/2014 të datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me Nr. 166A/13 i datës 02.09.2013 i ankuesit; Listën e pagave për muajin mars, prill, maj, qershor, korrik 2014 për ankuesin; Shkresën nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm; Kërkesën e datës 10.09.2014 të ankuesit; Ankesën e ankuesit e datës 01.10.2014 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Kërkesën për informata zyrtare e datës 19.12.2014, Përgjigje në kërkesë e datës 31.12.2014; Vendimi i datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; Lista e pagave për muajin gusht 2014; Përgjigje në ankesë e datës 01.12.2014 nga Komuna e Leposaviqit; Vendimin me numër A/02/528/2014 i datës 03.02.2015 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin me numër A.nr.1514/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 15.05.2019; Kërkesën për shqyrtimin e ankesës e datës 08.05.2019; Autorizimin e datës 02.03.2015..

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë si dhe duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1514/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankuesi ka një marrëdhënie të punës me Komunën e Leposaviqit në bazë të Akt Emërimit me Nr. 166A/13 të datës 02.09.2013 pasi që i njëjti në bazë të nenit 96 dhe 97 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është bërë akt emërim me afat të pacaktuar për pozitë të nëpunësit civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës konstaton se ndërprerja e marrëdhënies së punës respektivisht largimi nga lista e pagave së ankuesit është bërë me vendim të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit, pa u ndjekur asnjë nga procedurat ligjore të përcaktuara me legjislacionin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në shërbimin civil të Republikës së Kosovës ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk mund të bëhet me vendim arbitrar, sepse me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës janë të parapara mënyrat e përfundimit, pezullimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kështu që marrëdhënia e punës mund të ndërpritet për shkak të paafësisë së ushtrimit të detyrave në shërbimin civil sipas nenit 84 të këtij ligji, ndërprerja e marrëdhënies së punës mund të bëhet me vendim të njëanshëm vetëm në rastet të dorëheqjes apo shkarkimit sipas nenit 85 paragrafit 2 nën paragrafit 2.1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në nenin 86 dhe 87 janë parapara procedurat e dorëheqjes së nëpunësve civil respektivisht shkarkimet, ndërsa përfundimi i marrëdhënies së punës në bazë të nenit 90 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përfundon me: ***“arritjen e moshës së pensionimit; paafësinë e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore; përfundimin e afatit për punësimet me afat të caktuar sipas këtij ligji; dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër; vdekjen e nëpunësit civil”***.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që në rastin konkret të ankuesit nuk kemi të bëjmë me asnjë nga këto raste, po ashtu ndaj ankuesit nuk është iniciuar asnjë procedurë e tillë apo ndonjë procedurë



disiplinore për shkelje disiplinore pasi që vendimi për heqje nga lista e pagave është nxjerr në mënyrë arbitrare, rrjedhimisht Vendimi i datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit për heqje nga lista e pagave e ankuesit është vendim i kundërligjshëm i cili nuk ka dhënë arsytim të saktë dhe ka qenë i pa qartë dhe kundërtëhënës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, sepse ky ligj ka qenë në fuqi në momentin kur ankuesi është larguar nga lista e pagave, për me tepër edhe Komuna e Leposaviqit në përgjigje në ankesë të datës 01.12.2014 të dorëzuar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka mund të argumentoj me asnjë provë se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që çdo pretendim i tyre për ndërprerje të marrëdhënies së punës së ankuesit është i pabazuar, sepse ***nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë***, siç parashihet me nenin 45 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që Komuna e Leposaviqit është e obliguar që ankuesin ta kthej në vendin e punës “Zyrtar i Lartë Financiar” sipas Akt Emërimit me Nr. 166A/13 të datës 02.09.2013 në Komunën e Leposaviqit më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës dhe duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi, sepse heqja nga lista e pagave është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe Aktgjykimin me numër A.nr.430/15b të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1514/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.338/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;
- Menaxherit të Komunës së Leposaviqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së